


LUMTURIA VIE NGA



MIRËQENIA JONË

ME ZEMËR DEMOKRATIKE

ARBAS (10), LEJLA (10), BLEND (10), RINESA (10), ENGJËLL (11), ERISA (11)



Forcën e gjejmë tek vetja jonë, sepse të fillë na ka bërë demokracia

Shumë njerëz në botë, kanë frikë se nëse burrat dhe gratë do të trajtoheshin në mënyrë të barabartë, atëherë gjërat nuk do të funksiononin mirë. Ne jemi këtu t'iu tregojmë se nuk ka vend për frikë nëse ka barazi. Përkundrazi, çdo gjë do të jetë shumë më e thjeshtë dhe më e lehtë nëse të gjithë do t'i respektonim personat e gjinisë tjetër, ashtu siç ata edhe e meritojnë.

Barazia gjinore është më se e nevojshme edhe në familjet tona. Po t'ia bënim pyetjen vetes se a do të ishte më mirë nëse në një familje do të punonin të dy prindërit, përgjigja jonë do të ishte po. Është shumë më e përballeshme nëse do të ndodhte kështu, sepse të ardhurat do të ishin më të mëdha. Por, ne mendojmë se edhe punët e shtëpisë duhet të bëhen nga të dy prindërit p.sh. pastrimi i enëve, pastrimi i rrobave etj. Nëse kjo ndodh, atëherë asnjë anëtar i shtëpisë nuk do të lodhej shumë.

Deri më tani treguam për rëndësinë që barazia e ka në jetën tonë, por në demokraci kemi edhe shumë elemente të tjera që na bëjnë të ndihemi të sigurt. Një ndër to është liria. Ne nuk kemi pse të frikësohemi të dalim dhe të zhvillojmë çfarëdo aktiviteti që ne dëshirojmë, për shkak se ne jemi të lirë.

Element tjetër është toleranca, gjë për të cilën ne si qytetarë të Kosovës njihemi. Edhe pse jemi shtet i vogël, ne jemi praktikues të feve të ndryshme, por jeto-



Puna në grupe na ka bërë edhe më produktiv

jmë në harmoni me njëri-tjetrin. Kjo quhet tolerancë fetare. Këto elemente e plotësojnë formën e qeverisjes të quajtur demokraci. Dhe ne të fillë e duam, me plot gjëra të bukura që na ushqejnë me pozitivitet. Kosova edhe pse është formuar si shtet demokratik në vitin 2008, në thellësi ne çdo herë kemi qenë paqësorë dhe të denjë për të pasur një sistem të fillë.



E bëjmë me dashuri rolin e gazetarëve në demokraci

Po e vazhdojmë artikullin me disa informata të tjera në lidhje me demokracinë dhe vlerën e saj. Gjithashtu do të flasim edhe për sistemin demokratik në Kosovë

Folëm mjaft për barazinë gjinore dhe për elementet të cilat i posedon demokracia. Por, tani dëshirojmë ta ndajmë me ju atë që ne e mësuam sot në „Demos-ti“. Demokracia ka lindur shumë dekada e shekuj më parë, saktësisht në vitin 507 para erës sonë, në Greqi.

Në atë kohë, demokracia nuk ka qenë aq e zhvilluar sa është tani. Dhe kjo, për arsye të mungesës së vetëdijësimit të qytetarëve. Ata nuk kanë kërkuar të drejta të barabarta, deri sa e kanë vërtetuar se e vetmja zgjidhje për barazi është ta ngrisin zërin dhe të kërkojnë atë që iu takon.

Tani është gjithçka më ndryshe, sepse të gjithë jemi njësoj para ligjit.

Ne mund të dallojmë për nga feja, për nga gjinia, për nga raca, etj., por të drejtat që ne i kemi, na bëjnë që ne të jemi të barabartë.

Fjala demokraci, në gjuhën tonë do të thotë udhëheqje nga populli. Themi se në demokraci populli është ai që udhëheq në shtet, sepse kështu edhe ndodh realisht. Ne atë e bëjmë me anë të votave, me anë të të cilave ne i zgjedhim përfaqësuesit dhe përmes tyre, ne vendosim se çka do të ndodh me ne dhe me shtetin tonë. E themi me gojën plot se e vlerësojmë demokracinë, ashtu siç thotë populli „kokë e këmbë“, sepse falë saj, ne jetojmë të lirë dhe larg luftërave. Kështu jemi edhe shumë të lumtur.



Edhe pse jemi të ndryshëm, në demokraci jemi të barabartë

Ne punojmë së bashku



Për një gjë jam e bindur, se nuk ekziston asnjë lloj forme e qeverisjes përveç demokracisë, që na i plotëson kushtet dhe kërkesat tona si qenie njerëzore.

Demokracia na ka bërë që çdo ditë të zgjohemi me fytyra të buzëqeshura dhe me zemër plot dashuri

LIGJET, RREGULLA QË DUHET TË RESPEKTOHEN

ERDI (12), ELTON (10), MOLOSA (11), LEJLA (11), BEKIR (11)



Sa ka ndikim Kuvendi në jetën tonë? Çfarë vendime merren aty? Për ta kuptuar, lexojeni artikullin, sepse këtu i gjeni edhe përgjigjet

Në demokraci të gjithë ne fëmijët i kemi të drejtat e barabarta. Eh, sa mirë na bëjnë të ndjehemi liria dhe të drejtat që i kemi! Për shembull, kur ne dalim të luajmë në lagjen tonë, sepse e kemi të drejtën e lojës, askush nuk na e cenon këtë të drejtë. Po ashtu, secili prej neve e kemi të drejtën e shkollimit. Këto të drejta i kemi të garantuara me ligj. Por, a e dini se cili është ligji kryesor i shtetit tonë?

Akti më i lartë juridik i një shteti apo ligj mbi ligjet, është Kushtetuta e Kosovës. Të gjitha ligjet e tjera të cilat propozohen dhe miratohen, bazohen në këtë dokument. Kushtetuta e Republikës së Kosovës përbëhet nga 162 nene. Neni i cili flet për të drejtat e fëmijëve, është neni 50 në Kushtetutë, sipas të cilit të gjithë fëmijët

mijët gëzojnë të drejtën e mbrojtjes dhe të kujdesit të domosdoshëm për mirëqenien e tyre. A thua vallë ku merren vendimet për këto ligje?

Në grupin tonë kemi diskutuar pikërisht për një institucion i cili ndryshe njihet edhe si „Shtëpia e Popullit“, e që është Kuvendi. Në Kuvend merren vendime shumë të rëndësishme, pra aty miratohen ligjet. Deputetët e zgjedhur nga populli, i votojnë ato ligje, të cilat pastaj miratohen ose nuk miratohen varësisht nga numri i votave të tyre. Përveç që merren vendime për ligje, në Kuvend deputetët kontrollojnë punën e Kryeministrit, zv. kryeministrave, ministrave dhe zv. ministrave. Po ashtu, është e rëndësishme të përmendet që deputetët zgjedhen nga populli. Prandaj, Kuvendi ka funksion përfaqësues, sepse deputetët e përfaqësojnë popullin. Pra, me pak fjalë Kuvendi është institucioni më demokratik dhe më i rëndësishëm i vendit.



Kuvendi, vendi i ligjeve



Në grupin tonë punuam me shumë përkushtim

NDRYSHIMI FILLON ME VOTA

MERITON (11), EDLINA (12), ISAK (10), SHUAJB (11), SUELA (10)



Zana, një shoqe jona, ka shumë ide për projekte që kanë të bëjnë me komunitetin e saj, e që planifikon t'i realizojë në të ardhmen



Për t'i realizuar sa më parë këto ide, Zana i paraqiti ato tek prindërit e saj. Prindërit dëgjuan me kujdes idetë e Zanës



Prindërit e Zanës ditën e zgjedhjeve i menduan idetë e vajzës së tyre, dhe votuan kandidaten që menduan se do t'i ndihmoj t'i realizojë ato

E drejta e votës është e drejtë e çdo individi. Se kur qytetarët e fitojnë këtë të drejtë, iu informon artikulli ynë

Demokracia si sistem i qeverisjes ka synim që të gjithë qytetarët të trajtohen në mënyrë të barabartë dhe të mos ekzistojnë dallime mes tyre. Një element që mund të dallojmë që qytetarët trajtohen në mënyrë të barabartë, është pjesëmarrja në procesin zgjedhor. Nuk ka ndodhur asnjëherë që në vendin tonë të bëhen përjashtime e që ndonjë qytetar të mos lejohet të marrë pjesë në procesin zgjedhor vetëm se i përket një etnie, feje apo gjinie të caktuar. Ashtu siç i gëzojnë edhe shumë e shumë të drejta të tjera, ata e gëzojnë edhe të drejtën për të marrë pjesë në procesin zgjedhor.

Pse është e rëndësishme pjesëmarrja e qytetarëve në zgjedhje? Kosova, vendi ynë ka demokraci përfaqësuese. Kjo nënkupton që populli është ai që me vota të lira i zgjedh përfaqësuesit e vet. Jo të gjithë qytetarët kanë kërkesa dhe nevoja të njëjta. Ato variojnë në bazë të qytetarëve. Për shembull, për disa qytetarë më e rëndësishme mund të jetë shëndetësia sesa ekonomia. Kurse, për disa të tjerë mund të jetë e kundërta. Për këtë është shumë e rëndësishme që të gjithë qytetarët të marrin pjesë në procesin zgjedhor dhe t'i votojnë ata kandidatë për të cilët mendojnë se do t'i plotësojnë më së miri nevojat e tyre.

Për t'i zgjedhur përfaqësuesit e tyre, qytetarët mbi moshën 18 vjeçare marrin pjesë në dy lloje të zgjedhjeve; në zgjedhjet komunale dhe parlamentare. Në këto të fundit, qytetarët votojnë për kandidatët për deputetë, kurse në zgjedhjet komunale për kryetarë të komunës dhe asamblistë. Qëllimi i këtyre përfaqësuesve është mirëqenia e qytetarëve. Me votat që qytetarët u japin atyre ua besojnë fuqinë për të vepruar dhe për të përmirësuar zhvillimin e vendit.

Gjatë leximit të artikullit tonë do të vëreni se ka më shumë fakte, por për ta bërë më tërheqës leximin e artikullit jemi munduar që përmes vizatimeve të paraqesim një shembull të vogël se si edhe ne mund të jemi ideator për ndryshime, edhe pse jemi të vegjël në moshë. Ne e kemi zgjedhur rrugën e suksesit. Edhe për ju e dëshirojmë të njëjtën gjë!



Disa nga nxënësit e klasës V-2



IMPRESUM



Ky publikim është produkt i punës së pjesëmarrësve të projektit „Demos-ti“ i cili realizohet nga



REPUBLIKA E KOSOVËS / KUVENDI
REPUBLIKA KOSOVA / SKUPŠTINA
REPUBLIC OF KOSOVO / ASSEMBLY

i implementuar nga



Projekti është mundësuar dhe përkrahur nga



ERSTE Stiftung

Redaktohet nga
Kuvendi i Kosovës

Qëllimi i publikimit
Edukimi qytetar nëpërmes metodave edukative joformale

shtypur nga
TOKA

Na kontaktoni për të marrë pjesë: Pjesëmarrësit:
Tel: +381 38 704 560 SHFMU „Sadulla Brestovci“
E-mail: info@demos-ti.org Klasa: V-2
Website: www.demos-ti.org Vendi: Gjilan